



Nr i Protokolit 980

01.11.2021

Rahovec

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, nenit 68 të Ligjit Nr. 06L-114 për Zyrtaret Publik, Ligjit për Arsimin Para universitar në Republikën e Kosovës, Nr.04/L-032, të datës 29.08.2011, nenit 34 dhe 35, Ligjit për Arsimin në Komunitet në Republikën e Kosovës, Nr.03/L-068, neni 5, paragrafi c, Udhëzimit Administrativ të MASHT-it. Udhëzimit Administrativ të MASHT-it Nr.05/2015, Për Normativ për Kuadrin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, Drejtoria Komunale e Arsimit në Rahovec shpall:

Konkurs

Për plotësimin e **1 pozite** të lirë të punës me kuadër profesional të arsimit, për vitin shkollor 2021/2022:
Mësimdhënës/e për Lëndën e Infermierisë me 10 orë mësimi në javë.

Kushtet për konkurim:

Për vendin e punës kërkohet kualifikim përkatës profesional sipas U.A.05/2015, Udhëzimi Administrativ për Normativ mbi Kuadrin e Arsimit dhe Aftësimin Profesional, ndërsa kualifikimet tjera që nuk janë në përputhje me këtë udhëzim administrativ nuk do të merren në konsideratë.

Dokumentet e nevojshme:

- Kopjen e diplomës së fakultetit të kryer, të noterizuar,
- Kopjet e çertifikatave të trajnimeve me bazë në shkollë.
- Kopjen e ekstraktit të lindjes.
- Kopjen e letërnjoftimit.
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime.

Mënyra e aplikimit:

Dokumentacioni i aplikimit, dorëzohet në kopje fizike së bashku me formularin e aplikimit në DKA. Formulari i aplikimit merret /shkarkohet nga linku: <https://konkursi.rks-gov.net>

Lista Pritëse:

Kandidatët të cilët grumbullojnë më shumë se 59 pikë, hynë në Listën pritëse si kandidat fitues, dhe nëse paraqitet nevoja për ndonjë pozitë të lirë – **Mësimdhënës/e për Lëndën e Infermierisë**, kanë të drejtë të punësohen.

Themelimi i marrëdhënies së punës:

Marrëdhënia e punës themelohet vetëm nga dita e nënshkrimit të kontratës së punës .

Aplikimi në konkurs:

Afati i aplikimit fillon nga data 02.12.2021 dhe zgjat 15 ditë kalendarike dhe atë deri me datë 16.12.2021, deri në ora 16⁰⁰.

Rahovec,
01.11.2021



Avni Morina, Drejtor